



**Politika e privatësisë
Iniciativa “Ballkani i Hapur”.**

**Njoftim për mbrojtjen e të dhënave personale për personat që kontaktojnë Shërbimin
Kombëtar të Punësimit për ofrimin e shërbimeve**

Për të mbrojtur të drejtën tuaj për privatësi, të garantuar me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dëshirojmë t'ju informojmë për sa vijon:

Detajet e kontaktit të operatorit

Të dhënat tuaja personale përpunohen dhe tregohet kujdes nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit i Republikës së Serbisë, i cili ka statusin e një organizate për sigurimet e detyrueshme shoqërore, me seli në adresën Kragujevac, Rr. Svetozara Markovića 37, Numri i Regjistrimit: 17539957.

Për të gjitha pyetjet shitesë rreth shërbimeve të ofruara nga operatori, në kuadër të Inicativës “Ballkani i Hapur”, mund të dërgoni një e-mail në adresën: openbalkan@nsz.gov.rs ose me postë në adresën postare: National Employment Service, Directorate, Working Unit in Belgrade: 8 Kralja Milutina St., Belgrade, Republic of Serbia.

Baza ligjore për ofrimin e shërbimit

Ligji për Punësimin dhe Sigurimin për Papunësinë (“Gazeta Zyrtare e RS” Nr. 36/09, 88/10, 38/15, 113/17 - ligji tjetër, 113/17 dhe 49/21), Ligji për Punësimin e Shtetasve të Huaj. (“Gazeta Zyrtare e RS” Nr. 128/14, 113/17, 50/18 dhe 31/19), Ligji për Konfirmimin e Marrëveshjes për Ndërlidhjen e Skemave për Identifikimin Elektronik të Shtetasve të Ballkanit Perëndimor (“Gazeta Zyrtare e RS - Marrëveshjet Ndërkombëtare”, Nr. 27/21), Ligji për Konfirmimin e Marrëveshjes për Kushtet për akses të Lirë në Tregun e Punës në Ballkanin Perëndimor (“Gazeta Zyrtare e RS - Marrëveshjet Ndërkombëtare”, Nr. 27 /21).

Qëllimi i përpunimit të të dhënave personale

Shërbimi Kombëtar i Punësimit, si shërbimi publik i punësimit i Republikës së Serbisë, kryen veprimtari punësimi dhe ofron shërbime për punëkërkuesit dhe punëdhënësit. Nëse zgjidhni opsionin ndihmë për punësim nga Shërbimi Publik i Punësimit i Republikës së Serbisë, duke u regjistruar në faqen e web-it të Shërbimit Kombëtar të Punësimit <https://www.nsz.gov.rs/employee> ju do të keni opsionet e mëposhtme:

- regjistrim të personalizuar në gjuhën tuaj amtare;
- të merrni informacion për një numër të madh të vendeve të lira të punës në të gjithë territorin e Republikës së Serbisë;
- të dalloheni dhe të kontaktoheni nga një numër i madh punëdhënësish;
- të kryeni kërkime të detajuara të vendeve vakante, sipas të gjitha kritereve përkatëse;



- të merrni informacion për vendet e lira të punës të shpallura nga punëdhënësit në degët e Shërbimit Kombëtar;
- të merrni këshilla të dobishme për objektin e kërkimit të punës dhe paraqitjen tek punëdhënësi (shkrimi i një rezymeje pune dhe kryerja e intervistës me punëdhënësin);
- të merrni informacion rreth të gjitha aktiviteteve në Shërbimin Kombëtar;
- të merrni tregues statistikorë për ofertën dhe kërkesën në tregun e punës në Republikën e Serbisë;
- të merrni akses në bazën e të dhënave të rregulloreve ligjore aktuale që lidhen me tregun e punës.

Për qëllim të ofrimit të shërbimeve të sipërpërmendura, Shërbimi Kombëtar i Punësimit përpunon vetëm të dhënat e nevojshme personale. Të dhënat tuaja personale mund të jenë në dispozicion të punëdhënësve, autoriteteve dhe organizatave kompetente shtetërore, organeve dhe organizatave të krahinës autonome dhe të vetëqeverisjes lokale, si dhe personave të tjerë juridikë dhe fizikë me kompetenca publike.

Për të mbrojtur të drejtën tuaj për privatësi, ju informojmë se keni:

- të drejtën për të hyrë në të dhënat tuaja;
- të drejtën për të kërkuar korrigjimin e të dhënave tuaja;
- të drejtën për të kërkuar që ne të fshijmë të dhënat tuaja;
- të drejtën për të kufizuar përpunimin e të dhënave tuaja
- të drejtën për të bërë ankesë nëse besoni se është shkelur e drejta juaj për privatësi dhe e drejta për të paraqitur një ankesë pranë Komisionerit për Informacionin me Rëndësi Publike dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

Ju lutemi kini parasysh se Shërbimi Kombëtar i Punësimit nuk kryen vendimmarrje dhe profilizimin e automatizuar individual.

Për të gjitha pyetjet shtesë në lidhje me këtë politikë të privatësisë dhe kërkesave për të ushtruar të drejtat e sipërpërmendura të privatësisë, ju mund të dërgoni një kërkesë në adresën: lzzpol@nsz.gov.rs.

Të dhënat tuaja do të trajtohen si informacion konfidencial dhe do të ruhen përgjithmonë në Republikën e Serbisë, në përputhje me Ligjin, me zbatimin e masave të duhura teknike, organizative dhe të burimeve njerëzore që garantojnë sigurinë e tyre, dhe përpunimi i të dhënave tuaja do të kryhet vetëm nga punonjës të autorizuar të Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Të dhënat tuaja mund t'i transferohen një shteti nënshkruar të Marrëveshjes për Kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor.

Duke pasur parasysh se Shërbimi Kombëtar i Punësimit do të mbajë shënime për të dhënat tuaja personale, është e nevojshme që të na jepni të dhëna të sakta dhe të plota. Përndryshe, nuk do të mund të përdorni shërbimet e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.